



THIRRJE PËR GRANTE PËR FINANCIMIN E SKEMAVE TË REJA TË BIZNESIT OSE ZGJERIMIN E BIZNESEVE EKZISTUESE

Dorëzimi i ideve të biznesit nga sipërmarrëset e reja dhe ato ekzistuese përfshirë në aktivitetet e biznesit/zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve në Qarkun Shkodër (AL) dhe Komuna Ulqin (MNE).

TITULLI I PROJEKTIT:

Women microenterprise development in the cross-border area
Kontrata nr: CFCU/MNE/284

Vështrim i përgjithshëm

Komuna e Ulqinit në partneritet CODE Partners dhe OJQ MoGuL po zbatojnë projektin dyvjeçar “Women microenterprise development in the cross-border area”, i financuar nga Bashkëpunimi Evropian bashkëfinancuar nga Ministria e Zhvillimit dhe Investimeve Rajonale dhe Bashkëpunimit me OJQ e Malit të Zi, në kuadër të programit IPA BNK MNE-ALB 2014-2020.

Qëllimi kryesor afatgjatë i projektit është forcimi i iniciativave të sipërmarrjes së grave në rajonet e Ulqinit dhe Shkodrës dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për zhvillimin e bizneseve mikro dhe të vogla të grave në zonën ndërkufitare.

Për të arritur qëllimet e synuara të projektit, Komunat e Ulqinit dhe CODE Partners hapin thirrjen për grante për financimin e bizneseve ekzistuese dhe bizneseve të reja/start-up për të promovuar dhe pilotuar qasje dhe praktika të reja për aktivitete biznesi.

Skema e financimit bazohet në përvojën e fituar nga të tre zbatuesit e projektit në Shqipëri dhe Mal të Zi gjatë shumë viteve me mbështetjen e donatorëve të tjerë.

Grantet janë të destinuara për gratë e kualifikuara / regjistruara në projekt me prezencë në **Komunën e Ulqinit** dhe Qarkun Shkodër me mision dhe strategji të fokusuar në gjenerimin e të ardhurave.

Kjo thirrje publikohet në faqen publike të Komunës së Ulqinit, CODE Partners, OJQ MogUL si dhe llogaritë e rrjeteve sociale.

Fusha e thirrjes

Kjo Thirrje për aplikim për financim e planeve të biznesit është e hapur për gratë e regjistruara në projekt, të cilat kanë një ide biznesi të ri ose zgjerimin e një biznesi ekzistues.

Qëllimi tematik i kësaj Thirrjeje përcaktohet nga **qëllimet e mëposhtme** :

Të rrisë përfitimet socio-ekonomike të grave në biznes.





Të mbështesë iniciativa të reja biznesi për gratë.

Shtrirja gjeografike e kësaj thirrje është e kufizuar në Komunën e Ulqinit dhe Qarkun e Shkodrës.

Aplikantët e kualifikuara

Biznes idetë/planet në kuadër të kësaj Thirrjeje do të dorëzohen nga gratë e regjistruara në projekt dhe që kanë ndjekur programin e trajnimit në kuadër të projektit 'Women microenterprise development in the cross-border area'. Për qëllime të kësaj Thirrjeje, gratë që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që aplikojnë për zgjerim e një biznesi ekzistues, duhet të ketë statusin e duhur ligjor sipas ligjit të vendeve përkatëse, në këtë rast Malit të Zi dhe Shqipërisë, të jetë i regjistruar për taksat, të mos ketë detyrime fiskale të papaguara dhe të ketë një llogari bankare aktive.

Aplikimi për mbështetje financiare

Skema e mbështetjes financiare do të zbatohet në dy faza:

- Faza e parë – Aplikimi me idenë e biznesit
- Faza e dytë – Aplikimi me biznesplan për zhvillimin e biznesit / Marrja e mbështetjes financiare për zbatimin e planit të investimit të parashikuar në biznes plan.

Formulari i aplikimit për idenë e biznesit mund të gjendet në faqen zyrtare të Komunës së Ulqinit: <https://www.ul-gov.me/alb> dhe CODE Partners: <https://arka.org.al>

Korniza buxhetore për çdo aplikim do të jetë **nga 3000 € deri në 5000 €**.

Afati kohor i zbatimit të grantit është maksimumi 6 muaj, nga **17.04.2026 deri në 17.10.2026**.

FAZA E PARË – APLIKIMI ME IDENË E BIZNESIT

Afati i fundit për paraqitjen e idesë së biznesit

Aplikantët e interesuar në Komunën Ulqinit (MNE) duhet të dorëzojnë idenë e biznesit të tyre në versionin elektronik në adresën: ipa@ul-gov.me, jo më vonë se **12.02.2026** në ora 16:00 CET.

Aplikantët e interesuar në Qarkun e Shkodrës (AL) duhet të dorëzojnë idenë e biznesit të tyre në versionin elektronik në adresën: info@codepartners.org, po jo më vonë se **12.02.2026** në ora 16:00 CET.

Për të aplikuar me idenë e biznesit sipas kësaj Thirrjeje, ju lutemi plotësoni **formularin e aplikimit** të disponueshëm këtu





Gjatë periudhës së thirrjes së hapur për grante, do të organizohen ditë informuese me datë 03.02.2026 (Ulqin) dhe 03.02.2026 (Shkoder) ku aplikueset potenciale do të kenë mundësinë të bëjnë pyetje dhe të marrin informacione shtesë.

Procesi i rishikimit dhe hapat e mëtejshëm

Procesi i shqyrtimit të ideve të biznesit do të zgjasë afërsisht 10 ditë nga data e mbylljes së afatit të aplikimit. Komisioni do të vlerësoj/zgjedhë idetë më të mira që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përshkruara më sipër. Vetëm aplikantët fitues do të marrin një përgjigje që përshkruan hapat e ardhshëm për përgatitjen e biznes planeve dhe aplikimin me plane të biznesit në fazën e dytë.

FAZA E DYTË – APLIKIMI ME PLANET E BIZNESIT

Afati i fundit për aplikimin me plane të biznesit

Aplikantët nga Komuna e Ulqinit (MNE) duhet të dorëzojnë planet e biznesit të tyre në versionin elektronik në adresën: ipa@ul-gov.me, jo më vonë se **27.03.2026** në ora 16:00 CET.

Aplikantët nga Qarku i Shkodrës (AL) duhet të dorëzojnë planet e biznesit të tyre në versionin elektronik në adresën: info@codepartners.org, po jo më vonë se **27.03.2026** në ora 16:00 CET.

Për të aplikuar me planin e biznesit sipas kësaj Thirrjeje, ju lutemi plotësoni **formularin e aplikimit** të disponueshëm këtu

Procesi i vlerësimit, shpallja e fitueseve dhe hapat e mëtejshëm

Procesi i vlerësimit të planeve të biznesit do të realizohet nga data 30.03.-08.04.2026. Komisioni do të përzgjedhë planet më të mira të biznesit që plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e thirrjes. Kontraktimi i përfitueseve do të realizohet deri me datë 17.04.2026.

Aplikantët të cilat nuk janë përzgjedhur për përfitimin e grantit në këtë fazë, do të ftohen të paraqesin biznes planet e veta në Konferencën e Donatoreve. .

